

Akt Thmelimi

I shoqerise tregtare "CRYPTO SMART" Sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhe respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tyre te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

Individ, banues ne Tirane , krijojme sot, me date 27.01.2021, shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "CRYPTO SMART" Sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulimi
Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur CRYPTO SMART Sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

Selia e Shoqerise
Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private "CRYPTO SMART" Sh.p.k do te kete seline ne Rrugen "Ali Kelmendi", Pallati 163, Shk 1, Ap. 7, zona Kadastrale 8230, Nr. i Pasurise 5/19+1-7, Volumi 11, Faqa 127 , Tirana.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te kriroje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Objektivi i Veprimtarise
Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

Te ideoje zbatoje dhe te menaxhoje rrjete te telekomunikacionit dhe transmetimit te te dhenave dhe interkoneksionet ne pergjithesi. Te plotesoje nevojat industriale, tregtare, sociale dhe te rezidenteve per sherbime telekomunikacioni. Te siguroje sherbime konsulence, keshillimi, trajnimi dhe kontrata sherbimi. Te interkonjektohet me ofrues te tjere sherbimesh dhe shoqeri te telekomunikacionit per te furnizuar sherbime end-to-end. Te ofroje sherbime audio dhe/ose audiovizive. Gjithashtu shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem.

Ofrim i sherbimeve VOIP, Cloud, Sherbime Aksesi dhe cdo sherbim tjeter te lidhura me Teknologjine e Informacionit.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Kapitali I Shoqerise

Neni 5



Kapitali fillestar I shoqerise private "CRYPTO SMART" Sh.p.k do te jete 5,000 (pese mije) Leke. Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakeve te shoqerise, e ndare ne 2 kuota.
Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj. Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me autorizim.

Ortaket e shoqerise, te ndare nga njeri tjetri, nuk kane te drejte mbi administrimin e shoqerise, veprimeve bankare apo cdo veprimtarie tjeter pa u shoqeruar me nje vendim te ortakeve te firmosur prej te gjithe ortakeve te shoqerise.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise, me vendim asambleje, mund te ndahen ne menyre te barabarte mes ortakeve te shoqerise ose te riinvestohen ne shoqeri per zgjerimin e aktivitetit te saj, permes nje vendimi te ortakeve te shoqerise.

Neni 8

Ortaket themelues kane te drejte te emeruje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .


Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "CRYPTO SMART" Sh.p.k.

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqerise.

Ortakët themelues te "CRYPTO SMART" Sh.p.k

Ylli Muca



Gentian Musaj

